



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

DIREKTIVA E MBROJTJES

2013

Hyrje

Viti 2012 shënoi një numër arritjesh cilësore për Forcat e Armatosura në të gjitha fushat e veprimtarisë dhe angazhimit të tyre. Hapa të rëndësishëm u hodhën veçanërisht në drejtim të përsosjes së procesit të planëzimit; dhe integritit të FA në NATO. U hartua dokumenti bazë i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, i cili parashtron rrugën e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të FA; u realizua me sukses me Komandën e NATO për Transformim, Konferenca e 5-të e Integritit në NATO, e cila certifikoi arritje të rëndësishme të FA; procesi i modernizimit u avancua me futjen në inventarin e Forcës Ajrore dhe Forcës detare, respektivisht të dy helikopterëve dhe dy anijeve të reja; një element i rëndësishëm ishte futja në përdorim e uniformave të reja me cilësinë dhe standardet më të mira të ushtrive të NATO, të cilat transformuan paraqitjen estetike të FA; angazhimi në operacionet e NATO në Afganistan njohu një stad të ri duke rritur peshën specifike të kontributit tonë me dy herë më shumë nga ajo që kishim 4 vite më parë, bazuar në standardet vlerësuese të NATO; u vijua me sukses procesi i asgjësimit të municioneve të tepërta dhe pastrimit të materialeve të tepërta, duke krijuar kushtet për përmbylljen e këtyre proceseve brenda vitit 2013; u hartuan një seri dokumentesh të rëndësishëm për menaxhimin më të mirë të personelit dhe u shtrua perspektiva e implementimit të politikave gjinore e shanseve të barabarta, politikave mjedisore etj. Shumë prej këtyre arritjeve dhe projekteve duhet të konsolidohen dhe çohen me tej gjatë vitit 2013.

Kjo direktivë të përbëjë bazën në të cilën do të mbështeten planet dhe programet e punës të veprimtarive të të gjitha strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes e të Forcave të Armatosura në përmbushje të misionit kushtetues si dhe detyrimeve që rrjedhin si vend anëtar i NATO, përgjatë vitit 2013.

I. PRIORITETET PËR VITIN 2013

Moto e kësaj direktive është: **Viti 2013 - viti vendimtar i realizimit të procesit të integritit të plotë në NATO dhe përsosjes së procesit të planëzimit në strukturat e FA.**

Në këtë kontekst, prioritetet kryesore për vitin 2013 do të jenë:

1. Realizimi i Objektivave të Planit të Integritit në NATO;
2. Planifikimi i detajuar i rekomandimeve të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM), hartimi i Planit Afatmesëm dhe Afatgjatë të Zhvillimit të FA dhe planit të implementimit të Objektivave të Aftësive (Capability Targets, CT).

Realizimi i Objektivave të Planit të Integritit në NATO: Periudha pas anëtarësimit dhe veçanërisht viti 2012 ka shërbyer për krijimin e eksperiencës së mjaftueshme lidhur me integrimin e plotë në NATO. Bazuar në këtë eksperiencë, viti 2013 duhet të jetë vit vendimtar për realizimin e plotë të Objektivave të Planit të Integritit në NATO. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet realizimit konkret të masave të parashikuara në Planin e Integritit me Komandën e NATO për Transformimin (ACT) dhe Komandën e Forcës së Bashkuar të Napolit (JFC-N). Konferenca e VI e Integritit duhet të kurorëzojë me sukses procesin 4-vjeçar të integritit të FA në NATO.

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM) dhe hartimi i Planit Afatmesëm dhe Afatgjatë të Zhvillimit të FA dhe planifikimi i detajuar i Implementimit të Objektivave të Aftësive:

RSM përcakton qartë se si do të jetë Forca e Armatosur e RSH dhe në cilat drejtime duhet të zhvillohet ajo. MM/SHP dhe gjithë strukturat drejtuese të FA duhet të përqendrojnë vëmendjen e tyre për zbërthimin e objektivave dhe planifikimin e implementimit të RSM si dhe të hartimit të Planit të Zhvillimit Afatmesëm dhe Afatgjatë të FA në përputhje me këto objektiva. Harmonizimi i programeve buxhetore afatmesme me përfundimet e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, Planet e Implementimit të CT, Planet Afatmesëm dhe Afatgjatë të Zhvillimit dhe Plani i Gjendjes Operacionale të Forcës ngelen sfidë madhore e vitit 2013 për të gjithë drejtuesit dhe planëzuesit e nivelit operacional dhe strategjik të strukturave të FA.

Plani i implementimit të rekomandimeve të RSM për strukturën dhe personelin të hartohet brenda muajit maj 2013. Implementimi të bëhet më 1 tetor 2013.

Paketa e re e objektivave “Blue Book” përcakton detyrimet kryesore të RSH si vend anëtar i NATO. Kjo paketë përfshin detyrime madhore për FARSH si Grup Batalioni, Grupi për Detyrë i Forcave Speciale (SOTG), Ekipi Mjekësor Role 2, etj, të cilat do të kërkojnë ngritjen e grupeve të posaçme të punës të cilët të analizojnë, studiojnë dhe zbërthejnë në plane konkrete e realiste implementimi këto objektiva në përputhje me kërkesat dhe standardet e NATO.

II. IMPLEMENTIMI I OBJEKTIVAVE TË VITIT 2013

Objektivat që i shërbejnë realizimit të prioritetëve të këtij viti duhet të zbërthehen në të gjitha fushat e veprimtarive kryesore të FA dhe të planëzohet qartë se si do të realizohen. Direktiva të shërbejë si një udhërrëfyes gjatë planifikimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të vitit 2013 dhe produkt konkret i dalë prej saj të jetë “Plani i Veprimtarive Kryesore të FA për vitin 2013”, si rezultat i bashkëveprimit dhe synimeve të nxjerra nga çdo strukturë e FA.

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes: Shtabi i Përgjithshëm i FA të koordinojë punën dhe të aktivizojë kontingjentet më të mira të ekspertëve ushtarakë për zbërthimin e detajuar të nevojave për zhvillimin konkret të kapaciteteve operacionale si dhe afatet kohore të implementimit të tyre.

Strategjia Ushtarake (SU) të bazohet në konkluzionet e dokumentit të RSM dhe Konceptin Strategjik të NATO. Drafti i SU të përfundojë brenda muajit mars 2013.

Plani Afatmesëm dhe Afatgjatë i Zhvillimit të FA të hartohet duke pasur parasysh RSM, detyrimet që burojnë nga “Paketa e Kapaciteteve”(CT), por edhe një vlerësim më realist të burimeve financiare. Procesi i përgatitjes së tij të udhëhiqet nga niveli më i lartë i Shtabit të Përgjithshëm. Dokumenti i Planit Afatmesëm dhe ai i Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FA të përgatiten brenda 6-mujorit të parë të vitit 2013 dhe të ketë një shtrirje kohore deri në vitin 2018 për Planin Afatmesëm dhe deri në vitin 2023 për Planin Afatgjatë.

Paketa e Objektivave të Kapaciteteve (CT) të konceptohet si pjesë integrale e Planit Afatmesëm dhe Afatgjatë të Zhvillimit të FA, si dhe e planeve të tjerë mbështetës. SHPFA të zbërthejë secilin nga objektivat e kapaciteteve, në dokumente programorë me masa të detajuara që duhen ndërmarrë për realizimin e tyre së bashku me koston dhe afatet përkatëse brenda muajit gusht 2013.

Paketa e Politikave Drejtuese të veprimtarisë së FASH, të përfshijë hartimin e politikave për krijimin e kapaciteteve operationale, me fokus tek politikat për personelin, arsimimi, stërvitjen, planifikimin e mbrojtjes, mbështetjen e FA me shërbime etj. Tematika e tyre të paraqitet për miratim tek ministri menjëherë pas përfundimit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes së bashku me draftet paraprake për secilën prej tyre.

Përsosja dhe modernizimi i procesit të planëzimit nga gjithë strukturat e FA

Gjatë vitit 2013 drejtoritë në MM/SHP dhe gjithë strukturat e FA të përqendrohen në modernizimin dhe përsosjen e planëzimit, njohjen dhe përdorimin e gjerë të metodave bashkëkohore informatike të planëzimit si dhe hartimin e planeve të detajuara, të kontrollueshme dhe të zbatueshme. Harmonizimi dhe zbërthimi i gjithë kërkesave të dokumenteve strategjike në plane veprimi të niveleve operationale dhe taktike duke caktuar objektiva dhe afate kohore të kthehet në metodë të zakonshme për planëzuesit e të gjithë strukturave të FA. Institucionet arsimore të FA të përfshijnë në programet e tyre më shumë tema dhe projekte lidhur me kuptimin dhe zbërthimin procesit bashkëkohor të planëzimit.

Standardizimi: Viti 2012 ishte viti i konsolidimit dhe i zgjerimit të dukshëm të procesit të standardizimit, duke bërë të mundur ratifikimin e 62 STANAG. Viti 2013 duhet të shënojë një zgjerim të mëtejshëm të procesit dhe puna të fokusohet jo vetëm tek ratifikimi por veçanërisht në planet e zbatimit dhe përdorimin praktik të STANAG në strukturat e FA. Shtabi i Përgjithshëm të raportojë në maj lidhur me implementimin e STANAG të miratuar. Përzgjedhja e STANAG/AP-ve të mbështetet në prioritetet, paketën e CT dhe planet e zhvillimit të FA.

Përfundimi i Reformës Ligjore të FA: Brenda vitit 2013 të përfundojë reforma ligjore me fokus në pesë ligjet kryesore që rregullojnë veprimtarinë e FASH siç janë: “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FASH”, “Për disiplinën ushtarake në FASH”, “Për medaljet për personelin në FASH”, “Për statusin e ushtarakut të FASH” si dhe ligji “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të FASH”.

Reforma e Personelit: Gjatë vitit 2013 të përmirësohen e plotësohen politikat, procedurat, planet dhe programet përkatëse për menaxhimin e integruar të përbërësve të ciklit jetësor të personelit, sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2011-2015.

Në vijim të dokumenteve të hartuar përgjatë vitit 2012, të hartohen tre dokumente të reja ku të përshkruhen politikat për përzgjedhjen dhe dërgimin e personelit në operatione jashtë vendit, për arsimimin, trajnimin, kualifikimin brenda vendit të personelit, vlerësimin fizik e shëndetësor të personelit si dhe një udhëzim për kontrollin e procesit të vlerësimit vjetor të personelit ushtarak.

Të rishikohet përshkrimi i punës së të gjithë personelit ushtarak që shërben në FA me synim futjen dhe aplikimin gjerësisht të procedurave standarde dhe përfshirjen e standardeve të NATO.

Kompjuterizimi i saktë i të dhënave të jetë baza për ofrimin e shanseve të barabarta për përparim në gradë e karrierë dhe arsimimin e trajnimin e personelit të FA. Gjatë vitit 2013 të përmirësohet dhe pasurohet me të dhëna database i personelit të FA. Të përfundojë sistemi i automatizimit të procesit të testimit të kandidateve për ushtarë profesionistë, të skanohen dosjet e personelit aktiv e atij në rezervë për të rritur aksesin kompjuterik dhe efikasitetin e shfrytëzimit të tyre, si dhe të përfundojë plotësimi i të dhënave të shtetasve që kanë kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak në vite.

Në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2013 të përfundojnë procedurat e llogaritjes së pensioneve për të gjithë ushtarakët në rezervë e pension si dhe të gjithë ushtarakët aktivë e në rezervë të pajisen me kartë identiteti ushtaraku.

Gjatë vitit 2013 të implementohet programi për mbështetjen dhe rehabilitimin psikologjik për ushtarakët pjesëmarrës në misione ndërkombëtare, si dhe për mbështetjen psiko-sociale të diferencuar për familjet e tyre.

Brenda 6-mujorit të parë të përgatitet një studim i plotë marketingu i bazuar në nevojat dhe kërkesat e një force ushtarake profesioniste, për të nxitur e përmirësuar motivimin e të rinjve e të rejave për tu bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

Brenda 6-mujorit të parë të përgatitet një studim dhe plan afatgjatë për mbështetjen sociale të ushtarakëve me fokus në aftësimin e bashkëshorteve të tyre për tregun e punës në bashkëpunim me OJF dhe Ministrinë e Punës, i cili të synojë në forcimin e qëndrueshmërisë së familjes.

Brenda 6-mujorit të parë të bëhet studimi dhe të hartohet një plan konkret për krijimin pranë KDS të njësive mbështetëse për fëmijët e ushtarakëve (kopësht ose çerdhe).

Brenda vitit të filloj zbatimi i projektit për ndërtimin e kampaundit të banimit të ushtarakëve në Kuçovë. SHP i FA si dhe drejtoritë e menaxhimit të personelit të vijnë në implementimin e politikave të barazisë gjinore dhe shanseve të barabarta të cilat duhet të konsiderohen vazhdimisht si prioritare.

Menaxhimi i Burimeve të Mbrojtjes

Burimet Njerëzore: Objektivi kryesor të jetë plotësimi i strukturave të Mbrojtjes me personel plotësisht profesionist, të aftë për plotësimin e misionit, në përputhje me përfundimet e RSM.

Të punohet për një strukturim të stafit të integruar të MM me objektiv shkurtimin apo reduktimin e disa struktura të cilat e kanë përfunduar misionin e tyre, si në Drejtorinë e Prokurimeve dhe në Drejtorinë e IT, dhe fuqizimin e plotësimin me kapacitete të Drejtorisë së Politikave të Mbrojtjes si një hap drejt reformës së plotë të stafit të integruar më afatmesëm.

Gjatë vitit 2013 të mbahen parasysh çështje si: rritja e cilësisë së arsimimit të oficerit, të nënoficerit dhe të ushtarit profesionist.

Ky vit të fokusohet në zhvillimin cilësor të korpusit të nënoficerit, ndërgjegjësimit të tyre, por edhe të korpusit të oficerëve lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë që kanë nënoficerët në realizimin e misionit dhe rritjen e profesionalizmit të FA. Në këtë proces duhet të përfshihen të gjitha komandat e forcave, komandat mbështetëse dhe njësitë e tjera të FA. Duke filluar nga viti 2013 të bëhet traditë zgjedhja e 10 nënoficerëve më të mirë të komandave të forcave, komandave mbështetëse dhe njësive të tjera të FA dhe mbi këtë bazë të zgjidhet nënoficeri më i mirë i vitit.

Burimet Materiale: Krijimi dhe konsolidimi i Sistemit të Kodifikimit dhe Informatizimit Logjistik të shërbejë për unifikimin e procedurave dhe të kodeve të menaxhimit të materialeve, sipas sistemit të NATO . Ky sistem të bëhet plotësisht funksional gjatë vitit 2013.

Programimi i burimeve të mbrojtjes: Programet e Mbrojtjes 2014-2019 të synojnë programimin e zhvillimit afatmesëm të FA, modernizimin dhe transformimin e tyre në një forcë me kapacitete operationale të aftë për të realizuar misionet kushtetuese dhe për të plotësuar detyrimet si vend anëtar i NATO. Gjatë periudhës janar -korrik 2013 të realizohet sinkronizimi dhe harmonizimi i mëtejshëm i fazës së programimit brenda strukturës së MM/SHP me Sistemin

e Integruar Kombëtar duke parashikuar nevojat për mbështetje financiare për objektivat e RSM, CT, Planet e Zhvillimit Afatmesëm dhe Afatgjatë të FA. Programimi i burimeve të mbrojtjes të mbajë parasysh deklaratimet e FA për pjesëmarrje në projekte në kuadër të konceptit “Smart Defense” të Aleancës.

Zbatimi i Buxhetit: Viti 2013 të jetë vit i zbatimit të një disipline të rreptë financiare bazuar në prioritetet e FA dhe i forcimit të kontrollit për realizimin e buxhetit me fokus në efektivitetin e arritur për shpenzimin e fondeve. Brenda 6-mujorit të parë të implementohet programi i kontabilitetit “Alpha” në të gjitha strukturat e FA dhe të përfundojë procesi i informatizimit të mbajtjes së kontabilitetit. Brenda 3-mujorit të parë të përfundojë shqyrtimi i personelit përgjegjës për financat, mbi bazën e testimeve të zhvilluara gjatë vitit 2012.

Angazhimi në Operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB

Angazhimi i FA në operacionin ISAF të drejtuar nga NATO të vijojë në përputhje me nivelet e angazhimit të miratuara për periudhën 2013-2014 si dhe me zhvillimet e politikave të Aleancës për tranzicionin në Afganistan, të synojë rritjen e cilësisë së përfaqësimit me personel trajnues si dhe pjesëmarrjen me oficerë shtabi në Komandat Rajonale në varësinë e të cilave vendi ynë ka dislokuar trupa. SHPFA të marrë të gjitha masat për të planifikuar, përgatitur dhe mbështetur me cilësi kontingjentet e ekipeve të këshillimit MAT, Forcave Speciale “Eagle” dhe përfaqësuesve tanë në NTM-A, PAT dhe shtabet e Komandave Rajonale në Afganistan. Në të njëjtën kohë me masat për vijimin e pjesëmarrjes së personelit tonë në operacionet KFOR dhe EUFOR, SHPFA të fillojë punën përgatitore edhe për angazhime të ardhshme të FA në operacionet e drejtuara nga OKB.

Siguria dhe Zbulimi: Në fushën e sigurisë, një rëndësi e veçantë t’i jepet sigurisë së informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” dhe të NATO, ngritjen e elementëve të rinj për mbrojtjen Kibernetike (Cyber Defence) dhe rritjes së standardeve të sigurisë fizike, përmes vënies në efikasitet të plotë të sistemeve dhe pajisjeve të integruara të sigurisë elektronike në strukturat e FA. Në fushën e zbulimit vëmendja të përqendrohet në informimin e autoriteteve vendimmarrëse për probleme aktuale dhe të perspektivës të operacioneve ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Objektiv konkret të jetë zhvillimi i kapaciteteve të zbulimit në nivel taktik në përputhje me objektivat e kapaciteteve dhe nevojave të FA.

Arsimimi ushtarak: Detyrë parësore për të gjitha nivelet e sistemit arsimor në FA të jetë konsolidimi i tij i mëtijshëm dhe lidhja me zhvillimet e FA dhe me standardet bashkëkohore me synim arsimimin e personelit me aftësitë e nevojshme për përmbushjen e misionit të FA.

Të ngrihet një grup-pune i cili brenda muajit prill të përfundojë një studim të plotë faktmbledhës për të gjithë problematikat që lidhen me sistemin arsimor në FA, mësimdhënien, cilësinë e personelit, standardet dhe përmbajtjen e kurrikulave. Në përfundim, grupi të paraqesë propozime konkrete për përmirësimin rrënjësor të sistemit arsimor në FA.

Brenda 6-mujorit të parë të hartohet një plan konkret për Shkollën e Kadetëve dhe të merren masat përkatëse për hapjen e saj në fillim të vitit akademik 2013-2014.

Hartimi dhe publikimi i Doktrinës Ushtarake të FA (DP-01) dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të “mësimeve të nxjerra” janë detyra specifike për vitin 2013.

Stërvitja: Gjatë vitit 2013 stërvitja të zbatohet një sistem objektiv i matjes së rezultateve dhe progresit në stërvitjen e njërive, reparteve e nënreparteve. Ky sistem të jetë i thjeshtë, i kuptueshëm, i zbatueshëm dhe sipas standardeve të NATO. Forcimi i rolit të nënoficerit si lider të përbëjë një nga drejtimet kryesore të aktivitetit stërvitor. Për nënrepartet e deklaruara në NATO “Pool of Forces” të vijoje procesi i vlerësimit dhe certifikimit sipas standardeve të NATO. Rëndësi e veçantë t’i kushtohet programimit, përgatitjes dhe certifikimit të forcave të deklaruara në grupimin e forcave të NATO.

Të planëzohet dhe zhvillohet brenda muajit prill një stërvitje e përbashkët me Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera të sigurisë për EOD.

Kërkim-Zhvillimi: Të vijoje plotësimi me personel të kualifikuar i Qendrës Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes (QSKM) dhe brenda 3-mujorit të parë të hartohet plani i saj kërkimor. Gjatë vitit 2013 puna kërkimore e saj të fokusohet në mbështetjen e MM me ekspertizë të avancuar për çështjet themelore të integritetit të plotë në NATO, reformave të sigurisë e mbrojtjes së vendit që rezultojnë nga SSK, SU dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes dhe zbatimin e paketës së Objektivave të Kapaciteteve.

Të ngrihet dhe të vendoset në operacionalitet në Ministrinë e Mbrojtjes brenda muajit prill, biblioteka elektronike e dokumenteve studimore. Brenda vitit të përfundojë plani i informatizimit të arkivave të FA.

Mbështetja Logjistike: Fokusi i punës së strukturave logjistike të FA të jetë funksionimi i logjistikës së integruar dhe planëzimi i mbështetjes logjistike bazuar në ciklin jetësor dhe standardet me të përparuara të NATO si dhe përdorimi i gjerë i informatizimit logjistik.

Zbatimi rigorozi i akteve ligjore dhe nënligjore për procedurat e prokurimit të fondeve të akorduara për blerje mallra, shërbime dhe investime për vitin 2013; vijimi i projektit të kompletimit të Forcave të Armatosura me uniformën e re; ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese; përfundimi i master-planeve për garnizonet kryesore në përputhje me planin e përhapjes; përfundimi i planeve për mbështetjen me transport të strukturave të FA; implementimi i normave dhe standardeve bashkëkohore në fushën e mbrojtjes së mjedisit të përbejnë drejtimet kryesore të veprimtarisë së Mbështetjes Logjistike.

Të përfundojë miratimi në 6-mujorin e parë i master-planit për bazën ajrore Kuçovë dhe të ndiqen procedurat për implementimin e tij.

Mbështetja Mjekësore: Drejtimet kryesore të punës të përfshijnë planëzimin e plotë për implementimin e CT që lidhen me kapacitetet operacionale mjekësore, informatizimin e të dhënave shëndetësore individuale, kualifikimin e personelit mjekësor, forcimin e kontrolleve periodike shëndetësore e të gjithë personelit të FA, vaksinimin dhe planëzimin e hershëm të mbështetjes me medikamente të strukturave.

Mbështetja dhe përballimi i emergjencave civile: Rëndësi e veçantë t’i kushtohet stërvitjes në formacione “task force” në përputhje me eksperiencën e zhvillimit në terren të operacioneve,

stërvitjes me përdorimin e simulimit kompjuterik, mbajtjes në gatishmëri të mjeteve ushtarake, planifikimit për mbështetjen e operimit të tyre, si dhe koordinimit me strukturat përgjegjëse kombëtare të emergjencave civile.

Demontimi i municioneve të tepërta: Viti 2013 është viti përfundimtar për asgjësimin e gjithë sasisë së municioneve në përmbushje të synimit të qeverisë të RSH. Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2013 të përfundojë demontimi i të gjithë municioneve të tepërta të kalibrave të tjerë me përjashtim të fishekëve 7.62mm, për të cilët të hartohet një plan i veçantë. Gjatë këtij viti, të planifikohet për asgjësim me demontim industrial e gjithë sasia e mbetur e municioneve, duke shtuar kapacitetet e linjave të demontimit industrial dhe bërjen e tyre më efektive. Procesi i demontimit të përfundojë brenda muajit qershor 2013. Vëmendje e veçante ti kushtohet masave të sigurisë, ruajtjes së mjedisit dhe evitimit të aksidenteve apo ngjarjeve të jashtëzakonshme. Deri në fund të vitit 2013 të reduktohen 10 grup-depo, gjashtë prej të cilave brenda 6-mujorit të parë. Në fund të vitit të mbeten vetëm 4 grup-depo në funksion të nevojave të FA.

Evadimi i materialeve të tepërta: Ndërkohë që 2012 ishte viti i evadimit të shumicës së materialeve, pajisjeve e sistemeve të tepërta, muaji Korrik i vitit 2013 duhet të shënojë përfundimin e këtij procesi. Brenda muajit maj, të fillojë procesi i shkatërrimit të armëve të lehta të cilat janë nxjerre jashtë përdorimit, procesi të mbyllet brenda vitit 2013.

Pronat e tepërta të cilat janë jashtë Planit të Vendosjes dhe Përhapjes të FA të transferohen nga përgjegjësia e administrimit të MM në bashkëpunim me institucionet përkatëse me prioritet; kthimin dhe kompensimin e pronarëve; kalimin kapital të institucioneve publike qendrore dhe lokale; kalimin në METE për shitje nëpërmjet procedurave përkatëse ligjore. Brenda 3-mujorit të parë të hartohet dosja-tip me dokumentet që duhet të ketë çdo pronë. Gjatë vitit 2013 të kompletohen dosjet për të gjitha pronat e tepërta në administrim të MM.

Mbrojtja e Mjedisit: Gjatë vitit 2013 të vazhdojë puna e nisur për zbatimin e detyrave të përcaktuara në Dokumentin e Politikave Mjedisore të MM, akteve ligjore dhe nënligjore, standardeve të NATO dhe BE në të gjithë veprimtaritë e strukturave të MM, brenda dhe jashtë vendit. Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2013 të realizohet menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane, të përfundojë sistemimi dhe trajtimi i ujërave të zeza në Jalë, Pashaliman, Durrës, Forcën Tokësore, Regjimentin e Mbështetjes në përputhje me projektet e përgatitura nga ISPMb. Brigada Logjistike brenda vitit 2013 të rehabilitojë mjedisin e poligoneve të demontimit; brenda muajit shkurt të grumbullohen në BrL të gjitha vajrat, gomat e dala jashtë përdorimit dhe të trajtohen më tej në përputhje me udhëzimet në fuqi. Brenda muajit prill, Uzinat Ushtarake të marrin masa për pajisjen me licencë mjedisore dhe për reduktimin e gazrave që dalin në atmosferë dhe konservimin e hirave.

Modernizimi i Forcave të Armatosura: Fokusi i punës të jetë në vijimin e atyre projekteve të cilat janë në proces. Për planëzimin e projekteve të reja të modernizimit të mbahet parasysh pritshmëria e mbështetjes buxhetore. Hartimi i projekteve të vijoje të orientohet drejt zgjidhjeve të integruara dhe të plota, të shtrira në disa vite buxhetore dhe drejt krijimit të raporteve të balancuara në modernizimin e armëve dhe shërbimeve.

Në Forcat Tokësore, investimet të synojnë në përfundimin e projekteve të nisura për modernizimin e batalionit të forcave speciale, të projektit të mbështetjes logjistike dhe vendosjes, përdorimit me efikasitet të investimeve të tjera të bëra në vite. Të hartohet brenda muajit maj

2013 plani afatmesëm i modernizimit me armatimin e lehtë të Forcës Tokësore me prioritet; batalionin e forcave speciale dhe batalionin e motorizuar.

Në Forcat Detare të synohet përfundimi i projektit të ndërtimit të anijeve patrulluese dhe hartimi i një plani për mbajtjen në efikasitet të plotë në të ardhmen i kantierit të Pashalimanit.

Në Forcat Ajrore të realizohet futja në përdorim operacional të helikopterëve Cougar, të rritet koeficienti i gatishmërisë teknike të helikopterëve në tërësi dhe aftësia operationale e ekuipazheve fluturues për përdorimin e helikopterëve. Brenda vitit të përfundojë plotësimi i kërkesave të plota operationale të NATINADS. Të vijojnë procedurat për sistemin ACCS.

Komandat të hartojnë programe mbështetëse për investimet e kryera, implementimin e një koncepti të ri mirëmbajtje dhe shndërrimin e këtij investimi në tregues operational. Investimet e reja të udhëhiqen nga analiza , menaxhimi i ciklit jetësor të tyre si dhe të jenë në harmoni me tendencat e zhvillimit të forcave të NATO.

Automatizimi: Fokusi i punës të jetë implementimi i plotë i konceptit të integruar për automatizimin në gjithë strukturat e FA, shpërndarja dhe përdorimi gjerësisht i moduleve të ndërtuara. Vëmendja të fokusohet në hartimin e planeve për identifikimin, trajnimin , kualifikimin e personelit për përdorimin e moduleve të ndërtuara si dhe planeve për vitalizimin e infrastrukturës kompjuterike të domosdoshme për funksionimin e sistemeve. Fusha e logjistikës edhe gjatë vitit 2013 të vijojë të jetë prioritare në procesin e automatizimit të resurseve duke përvetësuar edhe programet aktuale kompjuterike logjistike që përdor sot NATO.

Bashkëpunimi ushtarak me vendet e NATO dhe rajonit: Zgjerimi i hartës së bashkëpunimit, mbi bazën e parimit të “cost-sharing” dhe në shërbim të rritjes , konsolidimit të kapaciteteve tona dhe zhvillimit të FA; bashkëpunimi në funksion të realizimit të Objektivave të Kapaciteteve (CT), pjesëmarrjes në operatione të drejtuara nga NATO, BE apo OKB, si dhe në përballimin e emergjencave civile të përbëjnë synimet kryesore në fushën e bashkëpunimit ushtarak me vendet e NATO dhe të rajonit. Harta e bashkëpunimit dypalësh në fusha konkrete e konsoliduar gjatë vitit 2012 duhet të avancohet më tej.

Gjatë vitit 2013 të hartohet plani i detajuar për plotësimin e pozicioneve të alokuara për FA në komandat e NATO. Vëmendje e veçantë do t’i kushtohet zhvillimit të diplomacisë së mbrojtjes dhe bashkëpunimit në kuadër të SEEDM dhe A-5, si iniciativa shumë frutdhënëse.

Bashkëpunimi me Forcën e Sigurisë së Kosovës, përveç fushës së arsimimit dhe emergjencave civile të shtrihet edhe në fushat e stërvitjes së trupave, shtabeve, stërvitjes simuluese, mbështetjes logjistike dhe shëndetësore, prokurimeve etj. Grupet e punës nga MM/SHP të punojnë për konkretizimin e bashkëpunimit dhe hartimin e planeve të detajuara të veprimit në 3-mujorin e parë të vitit 2013.

Përgjegjësitë, Monitorimi dhe Raportimi: Në zbatim të kësaj direktive Drejtoritë në MM, Shtabi i Përgjithshëm, Komandat e Forcave, Brigadave dhe Reparteve Autonome të nxjerrin udhëzime dhe të hartojnë plane konkrete pune për aktivitetin e tyre dhe për strukturat vartëse. Lidhjet midis prioriteteve, objektivave, planit dhe rezultateve të punës së çdo strukture do të përbejnë bazën e finalizimit të saj.

Shtabi i Përgjithshëm dhe Drejtoritë në MM të raportojnë çdo 3-mujor për ecurinë e zbatimit të kësaj direktive. Afati i raportimit është java e trete e muajit prill, korrik, tetor 2013 dhe janar 2014.

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes për monitorimin e kësaj direktive dhe përgatitjen e raporteve përmbledhës për Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me ecurinë e zbatimit të saj. Kërkesat e parashtruara nga kjo direktivë do të jenë të zbatueshme menjëherë. Kjo direktivë do të publikohet e paklasifikuar në internet në adresën e MM: www.mod.gov.al

Pjesëtarë të Forcave të Armatosura,

Puna juaj për të shndërruar prioritetet dhe objektivat e Direktivës së Mbrojtjes 2013 në plane dhe rezultate konkrete të punës së çdo strukture do të jetë baza e finalizimit me sukses të saj.

Edhe në të ardhmen sfida jonë e përhershme do vijojë të mbetet arritja dhe ruajtja e standardeve të një vendi anëtar në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

MINISTRI I MBROJTJES

ARBEN IMAMI